



Republika e Kosovës/ Republic of Kosova

Kuvendi i Komunës Hani i Elezit Municipality Assambly of Hani Elezit



01/ N.102 /2011

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale të Komunave të Republikës së Kosovës 03/L-040, neni 24, neni 40, Ligjin Nr.03/L-049 Për Financat e Pushtetit Lokal neni 2, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 32.2, Shkresës përcjellëse nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa me numër 01Nr.102 të datës 08.09.2011. Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.09.2011 mori:

VENDIM

PËR

MIRATIMIN E BUXHETIT PËR VITIT 2012 DHE PARASHIKIMET BUXHETORE PËR VITET 2013-2014 TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT

I

Buxheti i përgjithshëm i Komunës së Hanit të Elezit për vitin buxhetor 2012 është në shumë prej 1.686.726 €, ndërsa vlerësimet për vitin 2013 janë në shumë prej 1.707.575 € dhe për vitin 2014 në shumë prej 1.720.882 €.

II

Në strukturën e të hyrave të tërësishme buxhetore për vitin buxhetor 2012 sipas pikës I të këtij vendimi, mjetet nga Grantet Qeveritare në shumë prej 1.436.727 €, shënojnë pjesëmarrje me 85.18% dhe të hyrat vetanake komunale në shumë prej 250.000 €, me një pjesëmarrje prej 14.82% në strukturën e përgjithshme të buxhetit.

III

Shpenzimet e përgjithshme buxhetore për vitin buxhetor 2012 parashikohen që të jenë të ndarë për Shpenzime Operative në vlerë prej 1.193.703 € dhe Shpenzime Kapitale vlerë prej 493.024 €.

IV

Shpenzimet buxhetore për vitin 2012 sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve parashikohen të kenë këto ndarje : Paga dhe Mëditjet 993.908 €, Mallrat dhe Shërbimet 152.000 €, Shpenzimet Komunale 30.795 €, Subvencionet dhe Transferet 17.000 €, dhe Shpenzimet Kapitale 493.024 €.

V

Për zbatimin dhe rishikimin e këtij vendimi për buxhetin e komunës, obligohet Drejtoria për buxhet dhe financa.

VI

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e aprovimit dhe do të vlejë për deri sa nuk merret ndonjë vendim tjetër.

VII

Me këtë vendim njoftohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Ministria e Financave, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe Shërbimi i Arkivit.

Hani i Elezit

Data: 26.09.2011

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Menduh Vlashi

